

Tema II: Funkcionimi i parlamentit

Leksioni 4: Organizimi i procedurave

Leksioni 5: Seanca plenare

Leksioni 5: Seanca plenare

- a) Drejtimi i seancës
 - b) E drejta e fjalës
 - c) Përdorimi i rregullores nga kryetari
 - d) Procesi i votimit
 - e) Mbajtja e rregullit në seancë
-

“Seanca është e hapur..”. Pas këtyre fjalëve të shqiptuara prej kryetarit të drejtimit të seancës, parlamentit fillon fazën më të rëndësishme të veprimtarisë së tij: seancën publike. E gjithë veprimtaria e parlamentit i shërben përgatitjes dhe zhvillimit të seancës, sepse në sallën e saj deputetët ushtrojnë të gjithë pushtetin, që rrjedh nga mandati i të zgjedhurit të popullit dhe nga kushtetuta: të votoj ligjin dhe të kontrollojë politikën e qeverisë.

Seanca plenare siguron publicitetin e debatit, pa të cilin rregjimi i përfaqësimit nuk do të ishte demokratik: kjo përbën thelbin e seancës plenare, madje arësyen e zhvillimit të saj. Për zhvillimin normal të seancës, aktorët e saj: kryetari, deputetët, qeveria, kanë një vend dhe një rol të përcaktuar me rigorozitet dhe diskutimet duhet të respektojnë gjithashtu disa rregulla, të përcaktuara prej rregullores dhe zakonisht, që ritmojnë punën dhe jetën e çdo institucioni parlamentar.

“Seancat e parlamentit janë të hapura”, është një dispozitë e pranishme në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike. Ajo afirmon qënien e një republike parlamentare, sepse rrjedh prej parimit sipas të cilit “sovrانيتi i përket popullit, që e ushtron nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.” Të sigurosh publicitetin e seancës do të thotë të lejojë popullin të asistojë në ushtrimin e sovranitetit nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Seanca është shprehje e pastër e debatit demokratik. “I gjithë kombi ka të drejtën të njohi punën e mandatarëve të tij. Do të ishte mirë, nëse do të ishte e mundur, që asambleja e deputetëve të popullit të zhvillohej në prani të gjithë popullit”, thoshte Robespieri qysh në vitin 1793.

Parimi kushtetues “i punimeve të hapura” shprehet përmes dëshirës së publikut të asistojë në sallën e seancave, megjithë vendet e kufizuara të destinuara për publikun, të botimit të proces verbaleve të seancës, që përbëjnë dokumentin më autentik të debateve parlamentare, si dhe të shtypit dhe mediave. Në mënyrë të veçantë transmetimet e drejtpërdrejta televizive “zgjerojnë shumë kapacitetin e tribunës së publikut” sepse e “fusin” seancën në shtëpitë e qytetarëve.

Sallat e seancave plenare, shpesh në formë gjysëm rrethore, janë simboli i vetë ndërtesave parlamentare, madje dhe i institucionit të parlamentit. Megjithëse një vend i vërtetë pune, ato kanë një karakter hijerëndë dhe solemn sepse mbartin historinë demokratike të çdo vendi, prandaj dhe dekorohen me shumë kujdes për të ruajtur traditat arkitektonike dhe historike. Në një sallë të tillë, aktorët e seancës plenare, kryetari, deputetët

dhe anëtarët e qeverisë, kanë vende të veçanta të përcaktuara nga rregulloret e parlamentit.

Në të gjitha rastet kolltuku i kryetarit vendoset në një tribunë të veçantë, në krye të sallës dhe në lartësi të tillë që të dominojë të gjithë aulën dhe të shoh lehtësisht të gjithë deputetët e vendosur zakonisht para tij, në vendet e caktuara sipas rregullores së parlamentit. Deputeti zë një vend të caktuar, që quhet i tij, sepse vetëm prej vendit të tij ai ka të drejtë të kërkoj fjalën, të flasë dhe të votoj. Në raste të caktuara ai mund të ftohet nga kryetari i seancës për të folur në tribunën e rezervuar për ndërhyrje të konsideruara si më të rëndësishme, si ato në debatet politike apo në diskutimet e përgjithshme për ligje të rëndësishëm. Ndërsa për aktorin e tretë, qeverinë, zakonisht ka dy tradita: e para, qeveria vendoset në një tribunë para deputetëve, me arësyetimin se qeveria jep llogari para deputetëve; e dyta, qeveria vendoset bashkë me deputetët, zakonisht në rrjeshtin e parë, me arësyetimin se anëtarët e qeverisë janë të barabartë, jo të privilegjuar, në debatin që bëjnë me deputetët. Zgjedhja e njërës prej këtyre dy mundësive, mesa duket është më shumë çështje e traditës së parlamenteve se sa një çështje me karakter parimor.

Përveç aktorëve dhe disa nënpunësve të autorizuar të shërbimit të seancës, asnjë person tjetër nuk mundet të hyjë në sallë. Në Francë, as Presidenti i Republikës nuk mund të futet, sepse ai komunikon me parlamentin nëpërmjet leximit të mesazheve. Sipas traditës, edhe Sovrani britanik nuk hyn në dhomën e komuneve. Mbreti i fundit, që ka hyrë në këtë sallë ka qënë mbreti Karlo I, në 1642, duke tentuar të arrestojë pesë anëtarë të parlamentit të akuzuar për tradhëti të lartë. Kur ai i kërkoj spikerit se nëse kishte ndonjë dijeni se ku ndodheshin ata, Spikeri iu përgjegj: "Madhëria juaj, më vjen keq, por në këtë moment nuk kam sy për të parë, nuk kam gjuhë për të folur, por dhe Dhoma së cilës i shërbej, nuk më lejon." Edhe fjalimet e kryetarëve të shteteve apo të qeverive që mbahen në sallën e seancës plenare, konsiderohen më shumë si pritje protokollare se sa një seancë parlamentare në kuptimin e saj kushtetues.

a) Drejtimi i seancës

Drejtimi i seancave përbën faqen më të dukshme dhe publike të veprimtarisë së Kryetarit. Kjo detyrë i takon drejtpërdrejt dhe personalisht atij. Por në praktikë, Kryetari nuk mundet vetëm të sigurojë drejtimin e të gjithë seancave plenare. Dihet që zgjatja mesatare e një seance është 4 orë paradite, 3-4 orë pasdite dhe po kaq, ndonjëherë më shumë, edhe në mbrëmje duke kaluar mesnatën jo rrallë. Gjatë gjithë kohës së zhvillimit të seancës vëmëndja e kryetarit duhet të jetë kostante në mënyrë që të plotësoj dy kushte të domosdoshme për zhvillimin e rregullt të procedurave: të respektojë rregulloren dhe të lejoj që të shprehen të gjitha opinionet.

Zakonisht për drejtimin e seancës, kryetari zëvendësohet nga një tjetër anëtar i asamblesë, kryesisht nga një zëvendëskryetar, që ushtron pothuaj të gjitha kompetencat e kryetarit në lidhje me drejtimin e seancës plenare. Në Shtetet e Bashkuara nuk ka zëvendëskryetarë të zgjedhur, në Dhomë Spikeri mund t'i besoj drejtimin e seancës për një periudhë të shkurtër kohe njërit prej kolegëve të tij. Në Westminster, në rastin e mungesës së Spikerit, funksionet e tij të drejtimit të seancës ushtrohen nga kryetari i komisionit të rrugëve dhe mjeteve dhe nëse ky gjithashtu mungon, prej njërit nga dy zëvendës kryetarët e këtij komisioni; kështu këta të tre plotësojnë rolin e zëvendës kryetarit. Në

Belgjikë ose Qipro, thirret deputeti më i vjetër (dekani). Në disa parlamente përcaktohen rregullat për caktimin e drejtuesit të seancës, por në përgjithësi kjo është një marrëveshje e bërë midis Kryetarit dhe zëvendësuesve të tij.

Në mënyrë të përgjithshme, drejtuesit e seancës, kushdo që të jetë statusi i tyre, ushtrojnë pothuaj të gjitha kompetencat e Kryetarit në seancë, me disa përjashtime që meritojnë të vihen në dukje¹. Kështu, në Mbretërinë e Bashkuar, kompetenca e seleksionimit të amendamenteve që do të nënshtrohen diskutimit, nuk mund të ushtrohet nga një zëvendës i tij, veçse në disa raste të kufizuara. Në Senatin italian, është e zakonshme që zëvendësit i lënë kryetarit të kryejë ai aktet më të rëndësishme të tilla si, mbajtja e rendit, caktimi i rradhës së votimit dhe deklarimi i rezultateve. Në Francë, Kushtetuta ja beson vetëm Kryetarit prononcimin mbi një papranueshmëri legjislative të kundërshtuar nga qeveria. Të tilla përjashtime janë të kufizuara dhe ndarja e drejtimit të seancave plenare, është mënyra më e mirë. Funkcionet kushtetuese ose administrative, të cilat i besohen një Kryetari, janë *intuitu personnae* dhe përgjithësisht nuk delegohen.

Dosja e Kryetarit, e përgatitur nga shërbimet parlamentare të seancës, përbën një mjet të domosdoshëm për të ndihmuar drejtuesin e seancës në zhvillimin e seancës në përputhje me rregulloren dhe rolin e tij të arbitrit. Përmbajtja e dosjes është në mvartësi të çështjeve që janë parashikuar në rendin e ditës: ato mund të jenë debate jo legjislative, diskutime të përgjithshme rreth projektligjeve, diskutime sipas neneve, dhe së fundi, çështje të lidhura me procedurat e kontrollit. Kur çështja është legjislative, dosja përmban: projektligjet që do të njoftohen në fillim të seancës, formula e rradhës së projektligjeve që përmban rendi i ditës, formulat e dhënies së fjalës ministrit ose raportuesve, lista e oratorëve të regjistruar në debatet e përgjithshme ose në diskutimet e përgjithshme, së bashku me kohën e akorduar, amendamentet e klasifikuara sipas rradhës që do të diskutohen, formulat e votimit. Megjithatë, gjatë zhvillimit të seancës dalin edhe çështje apo ndërhyrje të ndryshme, jo të parashikuara në fillim, por që duhet të moderohen gjatë drejtimit të seancës.

Kryetari i parlamentit ka kompetencën për të hapur, mbyllur ose ndërprerë seancën. Kompetenca më e gjithëpranuar është ajo që ka të bëjë me hapjen e seancës. Hapja e seancës është atribut ekskluziv i kryetarit të saj. Kjo procedurë nuk është thjeshtë formale. Pa u shqiptuar fjalët "seanca është e hapur", asnjë nuk ka të drejtën të marrë fjalën, asgjë nuk mund të regjistrohet nga sekretarët e debateve dhe natyrisht, asnjë vendim nuk mund të merret. Ndërsa kompetencat e mbylljes ose të ndërprerjes të punimeve të një seance mund ti nënshtrohen rregullave të ndryshme sipas parlamenteve. Në Francë dhe në vendet me traditë franceze, është kryetari që ka kompetenca më të mëdha: ai mundet në çdo moment të mbyll ose të ndërpresë seancën. Në parlamentet anglosaksone këto kompetenca janë përgjithësisht të përfshira në rregulloret, ku përcaktohen kushtet e ushtrimit. Ndërprerja e seancës lidhet me ekzistencën e prishjes së rendit dhe mundësinë e rivendosjes së tij. Ndërprerja e punimeve të asamblesë përbën një rast të rëndë, që duhet t'i nënshtrohet kushtëzimeve strikte. Në Bundestagun gjerman kryetari nuk mund mbyll ose të ndërpresë seancën para se rendi i ditës të jetë ezauruar, veçse në raste të jashtëzakonshme. Në Austri apo në Sudi këto vendime merren nga asambleja, kryetari ka kompetencë vetëm të propozojë. Mund të

¹ La presidence des Assemblees parlementaires nationales, Publie par l'UIP, 1997

ndodh që kryetari mund të mbyll seancën në rastin e një pjesmarrje të pamjaftueshme të anëtarëve të asamblesë.

Menjëherë pas deklarimit të hapjes së seancës drejtuesi i saj bën të njohur rendin e ditës që duhet të jetë në përputhje me kalendarin e punimeve. Parlamenti nuk mund të diskutojë dhe të vendosi për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Nëse ka propozime për ndryshimin e rendit të ditës vendimi duhet të rimerret nga organi që ka miratuar rendin e ditës, ose mund të vendosë edhe seanca plenare, por me një shumicë të cilësuar. Në Kuvendin e Shqipërisë² për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm. Propozimet për vendosje të çështjeve të tjera në rendin e ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi. Në rastet kur kërkesën nuk e bën grupi parlamentar, kërkesa paraqitet nga një deputet dhe grupi mbështetës i deputetëve ngrihet në këmbë.

Zakonisht seanca plenare në parlament fillon me miratimin e procesverbalit të seancës së mëparshme, i cili u është shpërndarë më parë deputetëve. Kur nuk ka vërejtje për tekstin, ai quhet i miratuar dhe, nëse kërkohet, ai votohet me ngritjen e dorës. Për procesverbalin fjala u jepet vetëm deputetëve që kërkojnë të propozojnë korrigjim ose të saktësojnë mendimin e tyre të shprehur në seancën paraardhëse për jo më shumë se 2 minuta. Në Kuvendin e Shqipërisë proces verbalet, pas pranimit, nënshkruhen nga Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari që drejton Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet dhe bëhen publike.

Me zbatimin e rregullores së vitit 2004, në Kuvendin e Shqipërisë pika e parë e rendit të ditës është diskutime për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Çdo deputet mund të diskutojë për çështje të ndryshme, që ai i konsideron se duhen bërë publike në seancë plenare. Në këtë rast deputeti nuk mund të flasë më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Drejtuesi i seancës kujdeset të harmonizojë diskutimet e çdo deputeti, sipas përkatësisë në grupin parlamentar. Koha e përgjithshme për diskutimin e këtyre çështjeve nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta. Në rastet kur diskutimet kalojnë këtë afat, Kryetari i Kuvendit ndërpret diskutimet e deputetëve dhe atyre që kanë ngelur pa diskutuar u jepet fjala në fillimin e seancës plenare pasardhëse. Një praktikë e tillë ka ndikuar në fuqizimin e debatit në Kuvend, sidoqoftë koha prej 60 minuta e vënë në dispozicion për këtë qëllim në çdo seancë ndoshta duhet të rishihet.

b) E drejta e fjalës

Fjala dhe vota janë “armët e betejës” së çdo deputeti. Ato janë të garantura prej mandatit të tij dhe ai i ushtron ato lirisht, ashtu si e gjykon vetë ai. Por përdorimi i tyre bëhet nëpërmjet disa rregullave, procedurave parlamentare, deputeti është i detyruar t'i respektojë ato. Pikërisht për shkak të procedurave, ka një dallim midis së drejtës së fjalës dhe së drejtës së votës. E drejta e parë duhet të kërkohet, që të ushtrohet, e drejta e dytë, ushtrohet pa u kërkuar individualisht. Kryetari i seancës është ai që publikisht të akordon

² Rregullorja e Kuvendit, 2009, neni 31, pika 2

të drejtën e fjalës, prandaj kjo është arsyeja që diskutimi i çdo deputeti fillon me fjalët “faleminderit, zoti kryetar”, është një falenderim për dhënien e të drejtës së fjalës. Në të kundërtën, kur fjala nuk i jepet ose i ndërpritet, kundërshtimi i deputetit për të kërkuar të drejtën e tij është i menjëhershëm, jo rrallë herë edhe i ashpër. Debatet për marrjen e fjalës apo ndërprerjen e saj, midis deputetëve dhe kryetarit të seancës janë shpesh prezente në seancat plenare.

Rastet kur deputetët kërkojnë të flasin mund të grupohen si më poshtë dhe për sejcilin rast rregulloret parlamentare fiksojnë procedurat përkatëse:

- në debatet apo diskutimet me karakter të përgjithshëm, ku përfshihen debatet politike, diskutimet e përgjithsme për projektligjet, mocionet e besimit apo të mosbesimit, si dhe diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës, debat që bëhet për 60 minuta në fillim të çdo seance në Kuvendin e Shqipërisë. Karakteristikë e përbashkët e këtyre debateve është se ato organizohen paraprakisht.

- në diskutimet për nenet dhe amendamentet, si dhe ato për procedurë, ku përfshihen diskutime në përgjithësi me karakter teknik, të cilat nuk janë të organizuara paraprakisht. Ndërhyrje të tilla zakonisht quhen imediate.

- në çështjet e kontrollit, ku përfshihen seancat e pyetjeve dhe interpelancave me anëtarët e qeverisë, që edhe këto nuk kanë nevojë për një organizim paraprak, sepse dispozitat procedurale janë qartësisht të preçizuara në rregullore.

Organizimi paraprak i seancës, që përfshin zhvillimin e debateve me karakter të përgjithshëm, është i pothuaj i detyrueshëm. Kjo zakonisht është në kompetencën e një organi kolegjal, i Konferencës së Kryetarëve (në Francë, Itali, Poloni, Shqipëri) dhe bëhet para fillimit të seancës. Në këtë rast, kryetari natyrisht që mund të bëjë propozime, por nuk ka kompetencë të vendosi. Në Bundestagun gjerman, nëse Kryetari mund të përcaktoj rradhën e thirrjes së oratorëve, janë grupet politike ato ato që organizojnë debatet dhe bëjnë konfirmimin e rradhës së tyre nëpërmjet asamblesë. Në Mbretërinë e Bashkuar, përkundrazi, nuk ekziston organizimi i debateve në kuptimin kontinental të termit, Spikeri i Dhomës është i vetmi që bën zgjedhjen e oratorëve dhe të momentit të ndërhyrjes së tyre. Deputetët nuk kanë të drejtë e fjalës dhe nuk mund të tërheqin vëmëndjen Spikerit. Megjithatë, nuk ekzistojnë kufizime të kohës së fjalës dhe të numrit të oratorëve të mundshëm; në teori, koha e debatit mund të jetë e pakufizuar, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme kur zbatohen dispozita specifike, që kufizojnë në tre orë debatet urgjente. Ky është një sistem i sofistikuar i organizimit të punës që rezulton prej negociatave midis shefave të qeverisë dhe atyre të partive të opozitës, që lejon planifikimin e kalendarit të punimeve parlamentare. Nëqoftëse nuk është e mundur të gjëndet një marrëveshje, qeveria disponon mjete të shpejtoj fundin e diskutimeve. Sipas procedurës së famshme të quajtur “gijotinë”, miratohet një mocion që fikson një limit të diskutimit. Kur ky limit përfundon, mocioni votohet, pavarësisht nga gjëndja e ecurisë së punimeve. Gjithashtu mund të kërkohej, zakonisht nga një kryetar i një grupi parlamentar të rëndësishëm, që të votohet një mocion për mbylljen e punimeve, por në këtë rast duhet të jetë marrë mirëkuptimi i Spikerit sepse nëse ky vlerëson që debati ka qënë i pamjaftueshëm, mocioni nuk mund të paraqitet. Kjo përbën një garanci të pakontestueshme për opozitën. Në Dhomën e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara, organizimi i debateve mbi tekstet më të rëndësishme i përket “Rules Committee”. Spikeri nuk merr pjesë në procedurë, por në cilësinë e tij

të liderit të shumicës ndikimi i tij nuk është i neglizhueshëm. Gjithashtu, diskutimi i një “çështje paraprake”, që në Kapitol ka të njëjtin kuptim me mbylljen, për të shpejtuar miratimin e një projektligji, duhet të jetë autorizuar nga spikeri

Në rastin e debateve të përgjithshme rradha e gjatë e folësve nga tribuna shpesh bëhet monotone; në këtë rast debati bëhet i lodhshëm dhe nuk ndiqet me interes. Megjithatë angazhimi i grupeve politike për këto seanca është shumë i madh sepse nëpërmjet diskutimeve të shumta ato përpriqen të vënë në dukje qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre për çështjet në diskutim, ato përpriqen të bindin, të mbështesin apo të kritikojnë një politikë ose një reformë legislative. Më shpesh këto lloj debatesh i drejtohen publikut sesa vetë palëve që marrin pjesë në debat. Ato i ngjajnë ndeshjeve të vërteta, por në fund të tyre, vështirë të merret vesh kush fitoi dhe kush humbi, pasi sejcila palë bën vlerësimet e veta. Në mjaft raste diskutimet e deputetëve krijojnë tension në sallë, thirrje kundërshtuese nga deputetët me opinione të kundërta apo ndërhyrje të ministrave për të bërë sqarimet që ata dëshirojnë. Nuk mungojnë edhe rastet kur për shkak të përplasjeve të forta midis deputetëve të shumicës dhe atyre të opozitës kryetari të detyrohet të ndërpresë seancën për një pushim të shkurtër,

Në rastin e diskutimit të projektligjeve, kryetari i një asambleje parlamentare natyrisht nuk ka atribut të vendosë për tekstin që do të diskutohet në seancë plenare. Një veprim i tillë do të supozonte që ai zëvendëson autorët e projektit ose komisionin që paraprakisht e ka shqyrtuar dhe amenduar, duke e implikuar atë për themelin e debatit. Përkundrazi, roli i tij konsiston në organizimin dhe drejtimin e shqyrtimeve parlamentare, pra, paraqet një karakter formal. Megjithatë, organizimi racional i punimeve dhe zhvillimi i mirë i debatit kërkojnë një klasifikim të amendamenteve të propozuara. Kjo mund të bëhet edhe nga kryetari i komisionit përgjegjës, ose nga lideri i shumicës ose nga sekretarët përkatës. Mund të ndodh, si në Greqi, që rradha e amendamenteve të rezultoj prej momentit të tyre të depozitimit, por përgjithësisht një klasifikim bëhet në shumicën e parlamenteve dhe kjo detyrë realizohet nga Kryetari. Ky respekton më shpesh rregullat procedurale. Kështu, në Francë ose në Rumani thërriten së pari amendamentet që janë më larg tekstit që ata ndryshojnë, ndërsa në Danimark diskutohen në fillim ato që janë më të rëndësishme. I përket kështu kryetarit të vlerësoj rëndësinë e ndryshimeve të propozuara. Por roli i tij a mundet të shkoj deri në seleksionimin dhe diskutimin e disave prej tyre? Një kompetencë e tillë do t'i lejonte atij të ndikonte, *es qualites*, mbi përmbajtjen e tekstit në diskutim dhe nuk do ti korespondonte funksioneve të tij. Megjithatë, ai mundet gjatë debatit të konstatojë faktin që për shkak të miratimit të neneve apo amendamenteve, disa prej tyre bëhen pa objekt.

Gjithashtu, kryetarët e asambleve, ndonjëse shumë rrallë, japin këshilla, madje direktiva për të interpretuar ose plotësuar tekstin në diskutim dhe në raste të tilla ndërhyjnë për arsye formale ose për të kujtuar termat e debatit. Kryetari gjithashtu mund të ndërhyjë në raste të caktuara për formulime të karakterit redaktues ose saktësimi gjuhësor. Megjithatë tërësia e këtyre ndërhyrjeve ka për karakteristikë të përbashkët zhvillimin korrekt të debatit dhe nevojën e qartësisë së parashtrimeve legislative dhe jo ndërhyrjen në themelin e diskutimit.

Përveç rasteve të debateve të përgjithshme apo diskutimeve për projektligjet, deputetët kërkojnë fjalën edhe për çështje të procedurës, për të replikuar apo për të shpjeguar votën kundër. Për çështje të procedurës fjala

jepet menjëherë. Janë *çështje të procedurës* kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e rregullores, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës të miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 3 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër, jo më shumë se 2 minuta secili dhe merret vendim me votim të hapur nga parlamenti me ngritjen e dorës. Deputeti ka të drejtën e replikës, kur ndaj tij janë shprehur fjalë të padenja apo të pahijshme, ose janë bërë diskutime që kanë shtrembëruar thelbin e fjalës së tij. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta. Për të njëjtin diskutim deputeti nuk mund të bëjë më shumë se një replikë. Deputeti, si dhe deputetë të tjerë nuk lejohen të bëjnë replikë ndaj replikës. Deputeti ka të drejtën e *sqarimit të arsyeve të votimit kundër* deri në 2 minuta. Kur kërkohet të bëhet sqarim për votimin kundër, atij i jepet fjala menjëherë pas votimit. Në fakt, deputetët kur kanë ezauruar mundësitë që u jep rregullorja për të rifolur, shpesh në mënyrë jo të drejtë kërkojnë fjalën për procedurë, për replikë apo për spjegim vote. Ndërhyrje të tilla, kur i shpëtojnë "filtrit" të kryetarit, shpesh bëhen shkak për rritje të tensionit midis deputetëve në sallë.

Si rregullohet e drejta e fjalës? Rregullimi i dhënies së fjalës në gjirin e asamblese deliberative përbën një nga çelsat e drejtimit të seancave. Një listë e folësve mund të vendoset paraprakisht, si është rasti në Gjermani, në Francë, në Itali etj. Në të kundërtën, si në Shtetet e Bashkuara ose në Mbretërinë e Bashkuar, një listë e tillë nuk ekziston. Kryesore është të dihet nëse Kryetari është ose jo dakord me dhënien e fjalës së atyre që e kanë kërkuar dhe kur ka një listë, të atyre që janë rregjistruar. Në të gjitha rastet në praktikë nuk është e mundëshme tu jepet fjala të gjithëve që e kanë kërkuar dhe në shumicën e rasteve vendoset një zgjedhje; është ky një pushtet i pakufizuar i Kryetarit?

Në rastin e një debati të organizuar, në Francë lista e folësve i komunikohet Kryetarit nga kryetarët e grupeve parlamentare, që tregojnë edhe rradhën sipas të cilës ata duhet të thërriten dhe kohën e fjalës së tyre. Pasi ka marrë këto të dhëna, rradha e ndërhyrjeve në seancë vendoset nga Kryetari. Në Finland, Kryetari ndjek rradhën sipas të cilës folësit kanë kërkuar fjalën. Në Itali dhe në vende të tjera Kryetari bën alternimin e folësve sipas përkatësisë së grupeve të ndryshme parlamentare. Por, në parlamentet me traditë britanike Spikeri ka hapësirë të pakufizuar për t'i dhënë fjalën një parlamentar pa mbajtur parasysh një listë nëse kjo ekziston. Parlamentarët që nuk kanë marrë të drejtën e fjalës nuk mund të kërkojnë këtë pranë kryetarit, i përket vetëm atij të sleksionojë folësit, kjo zgjedhje nuk mund të diskutohet. Duke e ushtruar këtë të drejtë lirisht dhe në mënyrë sovrane, Spikeri ndërkohë nuk mund të jetë arbitrar. Në Irlandë ai kujdeset që debati të jetë i ekuilibruar, duke alternuar folësit e qeverisë ose të shumicës dhe të opozitës dhe duke reflektuar peshat respektive të tyre. Në Francë, në debatet jo të organizuara nga Konferenca e Kryetarëve, në teori të gjithë ata që kërkojnë fjalën mund t'u jepet. Megjithatë kur dy folës me opinione të ndryshme ndërhyjnë, Kryetari mund të vendos për mbylljen e menjëhershme të diskutimeve; në praktikë kjo dispozitë nuk zbatohet shumë.

Pasi t'i ketë dhënë fjalën një deputeti, a mundet që Kryetari t'ja heqi atë? Nuk ka një përgjigje të vetme për këtë çështje dhe rastet ndryshojnë nga një

parlament në tjetrin, madje edhe kur kanë një traditë të përbashkët. Kështu Spikeri në Westminster mund të urdhëroj një folës të ndërpresi fjalën e tij, ndërsa në Zelandën e Re një herë që folësi është autorizuar të flasi, fjala nuk mund ti hiqet veçse nga asambleja, edhe në rastin e një sjellje të gabuar. Rasti më i zakonshëm është që kryetari ka kompetencë të heqi fjalën, por në kushtet kur deputeti shkel rregulloren.

Procedurat e dhënies së fjalës në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë saktësojnë se çdo deputet që dëshiron të diskutojë për një çështje të përfshirë ose të papërfshirë në rendin e ditës duhet të regjistrohet në sekretari para fillimit të seancës plenare. Lista e diskutuesve të regjistruar i bëhet e njohur deputetëve në fillim të seancës plenare. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet sistemit elektronik. Lejohet ndërrimi i radhës së diskutimeve ndërmjet deputetëve në marrëveshje mes tyre. Deputeti, i cili, kur i jepet fjala nga drejtuesi i seancës, nuk është në sallë, konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi. Drejtuesi i seancës u jep fjalën diskutuesve, sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar. Kur lista e diskutuesve ka përfunduar ose nuk e kërkon më fjalën ndonjë deputet tjetër, Kryetari u jep fjalën kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare, duke filluar nga grupi më i vogël në numër.

Anëtarët e qeverisë kanë të drejtë, dhe kur u kërkohet e kanë për detyrë, të marrin pjesë në seancë plenare. Atyre u jepet fjala sa herë që e kërkojnë. Në debatet me kohë të përcaktuar, fjala e anëtarit të qeverisë llogaritet në kohën e grupit parlamentar të cilit i përket. Kur anëtarët e qeverisë kërkojnë të flasin pas mbylljes së diskutimeve, rihapet diskutimi i çështjes që është në shqyrtim.

Çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në rregullore parashikohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta. Diskutuesi nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër. Kjo kohë dyfishohet kur diskutohet programi politik dhe përbërja e qeverisë, mocionet e besimit ose mocionet e mosbesimit, projektligjet që kërkojnë miratimin me shumicë të cilësuar sipas Kushtetutës, zgjedhje, emërim ose shkarkim titullarësh të organeve që zgjidhen nga parlamenti ose ratifikim marrëveshjesh ndërkombëtare. Kur çmohet e nevojshme për çështje konkrete, koha e diskutimeve mund të përcaktohet paraprakisht në Konferencën e Kryetarëve në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve, sipas përfaqësimit të tyre, por në çdo rast jo më pak se 10 minuta për një grup parlamentar.

A mundet të marri fjalën Kryetari në debat? Nëse Kryetari ndodhet në vendin e tij të drejtimit të seancës publike, roli i tij nuk është i pajtueshëm me atë të një pjesëmarrësi aktiv në diskutim, si në rastin e veprimtarisë legislative ashtu dhe në atë kontrollit. Prej pjesëmarrjes së tij në këto debate varet shkalla e angazhimit të tij politik, neutraliteti i tij, që përgjithësisht shprehet nëpërmjet abstenimit.

Është normale që Kryetari të ndërhyjë për të siguruar një zhvillim të mirë të debatit, t'i kërkojë një folësi të kthehet në temë kur largohet prej saj. Gjithashtu ai mund të marrë fjalën për të preçizuar kuptimin e tekstit që diskutohet, madje të propozojë një redaktim për të përmirësuar kuptimin. Në disa parlamente vihet re roli pedagogjik i disa kryetarëve që bëjnë sintezën e debatit duke kujtuar opinionet pro dhe kundër për të ndihmuar asamblenë në marrjen e një pozicioni. Në këto raste, edhe pse mund të kenë në një farë mënyre përmbajtje politike, kryetari mbetet në rolin e tij të arbitrit dhe ndërhyrjet e tij, janë pjesë përbërse e funksioneve të tij.

Por a mundet ai, si një parlamentar i zakonshëm, të ndërhyjë dhe të marr pjesë në debat? Për këtë çështje, asambljetë parlamentare ndahen, pothuaj në mënyrë të barabartë, midis dy tendencave. Në fushën e “jo” figurojnë kryesisht parlamentet e traditës britanike, ku një pjesmarrje e tillë do të prishte rregullën e paanshmërisë dhe të neutralitetit të Spikerit. Bën përjashtim këtu Dhoma e përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara, Spikeri i së cilës, larg modelit të Westminster, është shef i shumicës, megjithëse në praktik ndërhyrjet e tij janë pak të zakonshme.

Është më e vështirë të gjendet një uniformitet midis parlamenteve në të cilat kryetari pranohet të ndërhyjë në debat. Në parlamentet e demokracive të reja kjo është një gjë e natyrshme. Në këto raste Kryetari mund të shprehet por me kusht që të lërë fizikisht drejtimin duke u zëvendësuar në kolltukun e tij nga zëvendës kryetari. Kjo mënyrë praktikohet në Gjermani, në Danimark, në Finland, etj. Kjo praktikë mund të gjithashtu të ndiqet edhe në Francë, por kryetarët e të dy dhomave abstenojnë të marrin fjalën në debate. Në disa parlamente, është e ndaluar që kryetari të rimarri kolltukun deri sa debati në të cilin ai morri pjesë, të përfundojë. (Belgjikë, Spanjë, Hollandë, Norvegji, etj)

Si do që të jetë dhe në mënyrë të përgjithshme, ndërhyrjet e Kryetarëve, edhe të atyre të lidhur fort me një parti politike, si në Shtetet e Bashkuara, nuk janë shumë të zakonshme. Kjo mënyrë sjellje abstenuese zgjidhet nga vetë kryetari, ndërsa zëvendës kryetarët marrin më lehtë fjalën, me kusht që edhe ata kur flasin të lënë kolltukun.

c) Përdorimi i rregullores nga kryetari

Gjatë zhvillimit të një seance, është e zakonshme që të ketë kontestime për procedurat apo ndërhyrjet e bëra nga kryetari, prandaj detyra e tij është që për çdo rast për zgjidhjen e tyre ti referohet rregullores. Natyrisht detyra e tij e parë është t'i zbatojë ato dhe t'ja u kujtojë parlamentarëve të pakënaqur. Por, mundet që, përballë një situatë imediate, zbatimi strikt i rregullave të mos jetë i mjaftueshëm. Për këtë arsye në shumë parlamente Kryetarit i jepet e drejta të bëjë interpretimin e rregullores ose normave të tjera që rregullojnë jetën e asamblesë. Në këtë rast ai ndihmohet nga stafi i shërbimeve e specializuara, i cili qëndron pranë tij. Por kjo nuk mundësohet në të gjitha rastet. Kështu, sidomos në demokracitë e reja të Evropës lindore, si në Bullgari, Kroaci, Rumani, Lituani, etj, kryetari ka thjesht detyrën të zbatojë rregullat, jo t'i interpretojë ato. Kur një funksion i tillë i besohet kryetarit, interpretimi i tij nuk është gjithmonë i pakundërshtueshëm, ai mund të kontestohet përpara asamblesë ose një organi tjetër kolegjial të specializuar, si atij të ligjeve apo të rregullores. Çështje të tilla, shpesh delikate, bëhen objekt diskutimesh edhe në Konferencën e Kryetarëve apo në Byronë e Parlamentit. Në rastet e kontestuara mundet të kërkohet që asambleja të votojë në lidhje me qëndrimin e kryetarit, por kjo situatë është e rrallë. Në shumicën e rasteve, por kjo nuk është rregullë e përgjithshme, interpretimet e kryetarit bazohen tek precedentët, sidomos në rastet për të cilat rregullorja nuk shprehet. Referimet ndaj precedentit luajnë rolin e dispozitave të rregullores, ulin rrezikun e arbitraritetit dhe të njëanëshmërisë. Precedenti është mbrojtës i pakicës, që ajo mund ti referohet, kundër vendimeve të shumicës. Megjithatë, precedentët përgjithësisht nuk mund t'i imponohen kryetarit dhe ai mbetet autoriteti i zbatimit të tyre, ose i krijimit të precedentëve të rinj në funksion të situatës që duhet të përballohet. I takon kryetarit që të reagojë para një

vështirësie të panjohur dhe para heshtjes së rregulloreve, duke marrë vendimin që ai gjykon si të përshtatshëm.

d) Procesi i votimit

Asambleja parlamentare, në shumicën e rasteve, shprehet nëpërmjet votimit mbi çështjet që ajo shqyrton. Ajo nuk voton vetëm në fund të një seance interpelance, pyetjeje apo informimi; përkundrazi, në fund të gjithë seancave të tjera, kur është fjala për programin e qeverisë, për diskutimet legislative, për mocionet, për nenet, për amendamentet dhe në tërësi për projektligjin, pas debatit, vjen momenti i vendimit: parlamenti thirret të votojë. Votimi është në fakt procedura sipas së cilës një organ deliberativ merr vendimet e tij duke pasur demokratikisht një shumicë.

Në tekstet kushtetuese ose në rregulloret e parlamenteve, si në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë³ përcaktohet se “Votimi është vetjak. E drejta e votës nuk delegohet”. Në kushtetutën franceze shtohet edhe mundësia e delegimit: “Ligji organik mund të autorizojë në raste të veçanta delegimin e votës, por në këtë rast asnjë nuk mund të marrë delegimin e më shumë se një mandati.”

Ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat konsiderohen të miratuara nga parlamenti kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, me përjashtim të rasteve kur në dispozitat kushtetuese parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre. Kryetari i seancës plenare, në leximin e rendit të ditës, i njofton parlamentit edhe shumicën që kërkon miratimi i projektligjit ose i projektvendimit. Për çështje të veçanta, që lidhen me mirëfunksionimin e asamblesë zakonisht vendoset sipas rasteve të përcaktuara në rregulloret e brëndëshme të tyre.

Përpara çdo votimi, drejtuesi i seancës plenare verifikon numrin e deputetëve të pranishëm në sallë, nëse ky plotëson kuorumin e nevojshëm. Kuorumi është numëri i nevojshëm e deputetëve për të bërë një votim të caktuar apo për të filluar shqyrtimin e një çështje. Kryetari mundet me inisiativën e vet të bëjë verifikimin e kuoromit, kur e gjykon ai të nevojshme. Në një numër rastesh kryetari bën verifikimin e kuoromit me kërkesën e një ose disa parlamentarëve. Kërkesa për verifikimin e numrit të deputetëve të pranishëm shprehet me ngritjen në këmbë të kërkuësve. Për verifikimin e numrit të deputetëve, drejtuesi i seancës bën thirrjen në mënyrë elektronike ose nominale. Kur mungon numri i kërkuar i deputetëve për marrjen e vendimit, drejtuesi i seancës shtyn seancën për 60 minuta dhe në rast se edhe pas kësaj kohe nuk arrihet numri i kërkuar, e anulon atë. Në rast anulimi, drejtuesi i seancës plenare përcakton ditën e rimbledhjes së seancës me të njëjtin rend dite, duke deklaruar njëkohësisht edhe orën e votimit për atë rend dite. Shpesh kërkesat për verifikim kuorumi janë pjesë e manovrave të obstruksionizmit të parlamentit.

Kryetari i seancës, natyrisht ka për detyrë të drejtojë këtë etapë vendimtare të shqyrtimit duke bërë procedimin e votimit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që kryetari është rregullatori i momentit të votimit, ose i procedurës së zgjedhur. Përgjithësisht caktimi i momentit të votimit nuk është në varësi të kryetarit, por varet prej mënyrës së zhvillimit të debatit ose zbatimit të rregullave procedurale. Si rregull, votimi bëhet, kur debati është mbyllur. Kështu, në Shtetet e Bashkuara, spikeri mundet të hedhi në votim një çështje,

³ Rregullorja e Kuvendit, 2009, Neni 57, pika 1.

vetëm nëse Dhoma miraton një mocion që i jep fund debatit, ose kur koha e përcaktuar për debatin është konsumuar, ose, nëse nuk ka një limit kohor, në momentin kur ai e gjykon të përshtatshëm, por është traditë që nuk mund të procedojë me votim kur një folës dëshiron të shprehet. Rregullorja mundet gjithashtu të parashikoj që votimi të përdoret mbi një çështje kur dy folës shprehin mendim të ndryshëm; në këtë rast kryetari mund tu jap fjalën edhe ndërhyrësve të tjerë, nëse kjo gjykohet prej tij. Me fillimin e votimit nuk lejohet të bëhen më diskutime dhe as i jepet fjala ndokujt deri në shpalljen e rezultatit të votimit. Votimi nuk ndërpritet për asnjë arsye.

Karakterit publik i zhvillimit të seancave plenare sjell edhe atë të votimit. Votimi bëhet në përgjithësi i hapur, në raste të veçanta të përcaktuara në rregullore ai bëhet i fshehtë. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike. Votimi bëhet përherë i hapur në rastet e miratimit të programit politik dhe të përbërjes së qeverisë, të shqyrtimit të dekretit të Presidentit të Republikës për emërim dhe shkarkim ministri, të votimit të buxhetit të shtetit ose të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Një mënyrë e votimit të hapur është dhe votimi nominal. Votimi nominal mund të kërkohet nga një numër i caktuar deputetësh ose nga kryetari i një grupi parlamentar dhe vendoset me votim nga asambleja. Kërkesa për votim nominal duhet të formulohet në kohën që drejtuesi i seancës mbyll diskutimet, deklaron se do të kalohet në votim dhe përpara se të ketë ftuar deputetët të votojnë me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike. Në votimin nominal drejtuesi i seancës ose sekretari i caktuar prej tij thërret deputetët sipas rendit alfabetik të mbiemrit të tyre dhe ata përgjigjen me zë të lartë pro, kundër ose abstenim. Zakonisht në rastin e mocionit të besimit ose të mocionit të mosbesimit votimi bëhet nominal. Në rastin e votimit nominal, lista e deputetëve votues me shënimin e votës pro, kundër ose abstenim të secilit deputet, publikohet së bashku me materialet e seancës plenare.

Votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat. Zakonisht në dispozitat kushtetuese apo rregulloren e parlamentit përcaktohen rastet kur nuk mund të bëhet votim i fshehtë. Me përjashtim të këtyre rasteve, votimi i fshehtë mund të kërkohet nga një numër deputetësh dhe vendoset me votim nga asambleja. Kërkesa për votim të fshehtë duhet të formulohet në kohën që drejtuesi i seancës mbyll diskutimet, deklaron se do të kalohet në votim dhe përpara se të ketë ftuar deputetët të votojnë me ngritjen e dorës ose nëpërmjet mjeteve elektronike. Votimi i fshehtë bëhet duke hedhur në kutinë e votimit fletën e votimit ose në mënyrë elektronike. Fleta e votimit të fshehtë duhet të përmbajë të paktën objektin e votimit dhe alternativat e votimit pro, kundër dhe abstenim.

Megjithëse rregulloret e parlamenteve caktojnë qartë rastet kur votimi bëhet i hapur dhe kur duhet të bëhet i mbyllur, debatet për mënyrat e votimit janë të shpeshta. Thelbi i çështjes shpesh nuk është procedural. Grupet parlamentare, sidomos ato të shumicës, janë tepër të interesuar për disiplinën e votimit: ato dëshirojnë, sidomos kur shumicat janë të ngushta, që të gjitha votat të shkojnë sipas vendimit të marrë paraprakisht nga grupi. Kjo bie ndesh me përmbajtjen e mandatit të deputetit, sipas të cilit deputeti duhet të jetë plotësisht i lirë kur hedh votën. Ndërsa në votimin e hapur të projektligjeve respektimi i hierarkisë së ligjeve bëhet nëpërmjet madhësisë së shumicës (e thjeshtë apo e cilësuar), në votimin e mandateve të personave, respektimi i pavarësisë së tyre lidhet me nevojën e votimit të fshehtë. Presionet që shpesh bëhen për të votuar në mënyrë të hapur, në thelb nuk

lidhet me nevojën e transparencës së votimit, por me prirjen partitokratike të disiplinimit të votës.

Përsa i përket mënyrave të votimit, kryetari nuk është i lirë t'i përcaktojë ai vetë. Më shpesh, si në Gjermani ose në Francë, ato rezultojnë prej dispozitave të rregullores, që përcaktojnë, për shëmbull, rastet kur procedohet me një votim të fshehtë, ose përkundrazi, me një votim të hapur me thirrje nominale. Mënyrat e votimit mundet gjithashtu të përcaktohen para debatit nëpërmjet një organi kolegjal, ose në vartësi të një kërkesë të formuluar prej disa parlamentarëve, kryetarëve të grupeve, të komisioneve, madje të qeverisë. Së fundmi, ato mund të vendosen prej vetë asamblesë, si në Bullgari ose në Norvegji. Edhe kur kryetari fikson mënyrat e votimit, ndodh si në Danimark, që një grup parlamentar mund të kërkojë që votimi të bëhet me thirrje nominale. Megjithatë, në shumë parlamente, Kryetari vlerëson nevojën e procedimit me një kundër-provë, duke ndryshuar teknikën e votimit. Kështu, në Mbretërinë e Bashkuar, dhe në shumë vende të traditës anglo-saksone, si në Shtetet e Bashkuara, spikeri bën së pari një votim me gojë, parlamentarët ftohen të "thërrasin" miratimin apo refuzimin e tyre, fiton ai që thërret më fort. Një mënyrë e tillë rezervohet në rastet kur dëshirohet të kuptohet nëse ka një miratim unanim ose me shumicë të qartë. Nëse situata është e diskutueshme, atëherë procedohet me një votim të vërtetë, që kryhet më shpesh, sipas traditës së Westminster, nëpërmjet "ndarjes" fizike të parlamentarëve në dalje të sallës, ata që janë "po" dalin nga një derë, atë që janë "jo" dalin nga një derë tjetër. Në Francë kryetari normalisht bën votimin me ngritjen e dorës, por në rast dyshimi, mund të procedojë me deputetët të ulur dhe deputetët të ngritur, pastaj me një votim të hapur. Në Itali, kryetari vendos gjithashtu nëse do të procedohet me një kundër-provë.

Rezultati i votimit në seancë plenare shpallet nga drejtuesi i seancës, duke përdorur togfjalëshin "Miratohet nga parlamenti" ose "Nuk miratohet nga parlamenti". Mbikqyrja dhe verifikimi i procesit të votimit kryhet nganjëherë nga vetë kryetari, por kjo detyrë shpesh i lihet sekretarëve parlamentarë të ngarkuar me votimin. Në rast të parregullsive, nuk është e zakonshme që vetë Kryetari të ketë kompetencën e ripërsëritjes së votimit, por kjo mundësi parashikohet në disa parlamente si në Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar, Bullgari, etj, ndërsa në disa parlamente të tjera, kontestimi i votimit bëhet prej një grupi parlamentar, si në Itali, Poloni, etj. Në Kuvendin e Shqipërisë kryetari e ka kompetencën e ripërsëritjes së votimit kur ai e konsideron të parregullt⁴: *"Çdo votim i kryer në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose Rregulloren e Kuvendit është i pavlefshëm. Drejtuesi i seancës, pasi merr mendimin e Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet, urdhëron anulimin e votimit dhe përsëritjen menjëherë të tij."*

e) Mbajtja e rregullit në seancë

Mbajtja e rregullit gjatë seancës përbën një nga detyrat e rëndësishme të kryetarit të saj. Gjatë zhvillimit të seancës deputetët nuk duhet të ndërpresin fjalën e drejtuesit të seancës plenare ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe joparlamentare, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë deputeti, të përhapin informacione që çenojnë jetën private të cilitdo, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e parlamentit. Përgjithësisht rregulloret e parlamenteve i japin

⁴ Rregullorja e Kuvendit, 2009, Neni 61, pika 1

kryetarit kompetencat e nevojshme për këtë qëllim, por ka dhe raste të rralla, si në Japoni, Sllovakia etj, ku kryetari nuk disponon këto kompetenca. Në rastin e çrregullimeve në përgjithësi kryetari e ka kompetencën për të ndërprerë seancën, por jo gjithmonë ai ka dhe kompetencën për të dhënë sanksione, sidomos sanksione kolektive. Në shumë asamble kryetari disponon një "arsenal" masash për parlamentarët që thyejnë rregullat. Kështu, në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë⁵ përcaktohen këto masa disiplinore: a) tërheqje vëmendjeje; b) vërejtje; c) përjashtim nga seanca plenare; ç) përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare deri në 15 ditë. Megjithatë kjo kompetencë shpesh temperohet për arsye se vetë asambletë ndërhyjnë, ose si instancë apeli, ose kur disponojnë vetë të drejtën e dhënies së sanksioneve më të forta. Kështu, në Kanada ose në Slloveni sanksionet e dhëna nga kryetari, që mund të shkojnë deri në përjashtim, mund të apelojnë përpara asamblesë. Në asamblenë franceze kryetari mund të japi vetë sanksione disiplinore të lehta, por propozon në asamble aplikimin e sanksioneve më të rënda, deri në përjashtimin e përkohshëm. Në Danimark përjashtimi duhet të vendoset prej komisionit të rregullores. Në Itali, kryetari mund të japi vetë disa sanksione, përfshirë edhe përjashtimin nga salla e seancave, për atë që prish seancën, por sanksionet më të rënda vendosen nga Byroja. Konstatohet që shumicën e asambleve parlamentare, sanksionet që shoqërohen me përjashtimin e një anëtarit, kërkojnë ndërhyrjen prej dhomës, sepse përtej karakterit të tyre ndëshkues, këto sanksione lidhen me ushtrimin e një mandati parlamentar dhe për këtë arsye ato duhet të rrethohen me garanci serioze.

Meqënëse në Kuvendin e Shqipërisë mbajtja e rregullit në seancë plenare ka qënë shpesh problematike, është bërë kujdes që rregullorja e Kuvendit të saktësoj rastet e marrjes së masave disiplinore të lehta⁶ (tërheqje vëmendje, vërejtje) dhe rastet e marrjes së masave disiplinore më të rënda⁷, (përjashtim nga seanca, përjashtim nga kuvendi deri 15 ditë). Masat disiplinore të përjashtimit shoqërohen me sanksion financiar të mbajtjes së pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore

Në rastin e parë, kur deputeti thotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin e saj, i tërhiqet vëmendja nga drejtuesi i seancës plenare. Në rast se deputeti kërkon të japë shpjegime për veprimet e tij ose gjuhën e përdorur, fjala i jepet në përfundim të seancës plenare të asaj dite për jo më shumë se 2 minuta. Kur deputeti e përsërit shkeljen në të njëjtën seancë plenare, pasi i është tërhequr një herë më parë vëmendja, ose deputeti që cenon seriozisht rendin në seancë plenare, i jepet vërejtje nga drejtuesi i seancës. Masa disiplinore e vërejtjes jepet nga drejtuesi i seancës për deputetin që përdor për votim kartën e votimit të një deputeti tjetër. Vërejtja regjistrohet në procesverbalin e përmbledhur të seancës plenare dhe bëhet publike. Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga deputeti në seancë plenare tërhiqen prej tij në po të njëjtën seancë dhe deputeti kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa disiplinore e dhënë anulohet nga drejtuesi i seancës.

Në rastin e dytë, kur deputeti përdor fjalë fyese ose cenon personalitetin e drejtuesit të seancës apo vazhdon të kryejë shkeljen, pasi më parë në të njëjtën seancë janë zbatuar masat e lehta disiplinore, me urdhër të drejtuesit të

⁵ Po aty, neni 63

⁶ Po aty, neni 64.

⁷ Po aty, neni 65.

seancës, ai përjashtohet nga seanca plenare për atë ditë. Në rast se deputeti s'pranon të dalë nga salla, drejtuesi i seancës e ndërpret atë dhe i jep porositë e nevojshme shërbimit të sigurisë për zbatimin e urdhrin të dhënë. Kur deputeti bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në seancë që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon deputetët e tjerë, anëtarët e Këshillit të Ministrave ose përdor fjalë fyese për Presidentin e Republikës apo institucione të tjera shtetërore ndalohet të marrë pjesë në punimet e kuvendit, në seancë plenare dhe në komisione nga 2 deri në 15 ditë. Ndalimi i pjesëmarrjes vendoset nga Byroja e Kuvendit me propozimin e drejtuesit të seancës ose propozimit me shkrim të jo më pak se 7 deputetëve. Në rast se deputeti përpiket të hyjë në sallën e seancës plenare ose të komisioneve përpara mbarimit të kësaj mase ndërshkimore, afati i masës dyfishohet.

Përveç masave disiplinore të përshkruara më sipër, në rast se në sallë bëhet rrëmujë dhe nuk merren parasysh kërkesat e drejtuesit të seancës për mbajtjen e rregullit, drejtuesi i seancës lë vendin e tij dhe seanca plenare quhet e ndërprerë. Në rast se përsëri rrëmuja vazhdon, drejtuesi i seancës e pezullon seancën për një periudhë kohe të caktuar ose e mbyll atë. Në rast të mbylljes së seancës, Kuvendi mblidhet me të njëjtin rend dite të nesërmen, nëse nuk është ditë pushimi.

Është pikërisht meraku i pavarësisë, madje i sovranitetit të asambleve që komandojnë organizimin e mbajtjes së rendit dhe të sigurisë në brëndësi të asamblesë dhe që justifikon kompetencat e dhëna kryetarit në këtë fushë. Në të vërtetë, nëse forcat e rendit vetë ose me urdhër të pushtetit ekzekutiv do të hynin në sallën e parlamentit, është legjitime të dyshohet për lirinë e plotë të veprimit të pushtetit legjislativ. Për këtë arsye shpesh në rregulloret parlamentare parashikohet që vetëm kryetari mund të autorizojë forcat e rendit të hyjnë në asamble. Në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë është përcaktuar⁸ se punonjësit e shërbimit të sigurisë veprojnë në sallën e seancave plenare të Kuvendit vetëm me urdhër të kryetarit ose të drejtuesit të seancës dhe jashtë sallës së seancës plenare, sipas rregullave të përcaktuara nga Byroja e Kuvendit. Në Kanada, në Danimark ato mund të hyjnë vetëm me kërkesë e tij. Në Francë është vendosur që kryetarët mund të kërkojnë forcën e armatosur dhe të gjitha autoritetet që ata e gjykojnë si të nevojshme të marrin pjesë. Madje saktësohet se kryetari përcakton rëndësinë e forcave ushtarake që ai gjykon të nevojshme dhe që ato janë të vendosura në autoritetin e tij. Dhënia e mjeteve dhe kompetencave kryetarit për të siguruar disiplinën në brëndësi të asamblesë është garanci për qetësinë e nevojshme të zhvillimit të debatit dhe të funksionimit të rregullt të institucioneve dhe të demokracisë përfaqësuese.

⁸ Po aty, neni 122, pika 2